

## **GJYKATA E QARKUT TË MITROVICËS**

**P Nr. 46/10**

**13 Korrik 2011**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E QARKUT TË MITROVICËS, në Trupin Gjykses të përbërë nga Gjyqtari I EULEX-it, Klaus Jung, si kryetar I trupit Gjykses, si dhe Gjyqtarët e EULEX-it, Christine Lindemann-Proetel dhe Victor Pardal si anëtar të Trupit Gjykses, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjor të EULEX-it, Francesco de Sanctis si procesmbajtës, në çështjen penale kundër:

**Të Akuzuarit SH. K.**, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorit të Qarkut Prokurori Publik PP Nr. 114/2010 të datës 19 Tetor 2010 ,e veprën penale të Vrasjes së Rëndë në Tentativë sipas Nenit 147, pika 4 në lidhje me Nenin 20 të Kodit Penal të Kosovës, si dhe me veprën penale të Posedimit, Kontrollit, dhe Mbajtje në Pronësi, në Kontroll, në Posedim, në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve nga Neni 328 paragraf 2 të KPK-së;

Pas mbajtjes së seancave publike të shqyrtimit kryesor më 4, 5, 6, 8 dhe 13 Korrik 2011, të gjitha në praninë e të Akuzuarit Sh. K., avokatit të tij mbrojtës Mahmut Halimi, Prokurorit Publik të EULEX-it, Neeta Amin, Palës së dëmtuar B. O. dhe përfaqësuesit të tij ligjor Fazli Balaj, pas shqyrtimit të mbajtur nga Trupi Gjykses dhe votimit të mbajtur më 13 Korrik 2011, të njëjtën ditë në përputhje të Nenit 392, Paragrafit (10 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), në prani të publikut dhe në prani të të Akuzuarit të lartpërmendur, Avokatit Mbrojtës, Prokurorit Publik të EULEX-it dhe Palës së Dëmtuar, shpalli si në vijim këtë

### **AKTGJYKIM**

**Sh. K.**, me nofkën D. Sh., i lindur më \_\_\_\_\_, në fshatin \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, Kosovë, emri i babait A., emri i nënës S. I., me banim të përhershëm në fshatin \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, shqiptar, shtetas i Kosovës, i pamartuar, pa fëmijë, me shkollë të mesme, me të ardhura të vogla, më herët i dënuar për Vepër të Rëndë kundër të Sigurisë në Trafik;

është

### **FAJTOR**

Sepse më 17 Shtator 2010 rreth orës 07:00, në fshatin \_\_\_\_\_, komuna e \_\_\_\_\_, në afërsi të stacionit të autobusit afër pompës së benzinës “\_\_\_\_\_”, i akuzuari më dashje ka shtënë me revole – \_\_\_\_\_ të kalibrit \_\_\_\_\_ mm – së paku pesë herë në drejtim të palës së dëmtuar B. O., Komandant i Forcave të Sigurisë të Kosovës, duke i shkaktuar plagë të rënda në parakrahun e djathtë, këmbën e djathtë dhe në zogëzën e (këmbës së) majtë. Ditën kritike, pala e dëmtuar ishte duke udhëtuar në një makinë zyrtare të Forcave të Sigurisë së Kosovës së bashku me kolegët e

tij, S. G., R. R. dhe shoferi B. T., në drejtim të \_\_\_\_\_. Gjersa S. G. dhe R. R. ishin ulur prapa në makinë, B. O. ishte në ulësen e bashkudhëtarit përpara. Kur arritën në pikën e lartpërmendur të stacionit të autobusit , i Akuzuari, duke qenë gjithashtu anëtar i Forcave të Sigurisë të Kosovës, ngriti dorën për të ndalur makinën. Meqë makina u ndal rreth 20 – 30 metra larg të Akuzuarit, B. T. doli jashtë makinës të pyes pse i Akuzuari kishte dhënë shenjë që makina të ndalojë. Tre pasagjerët e tjerë mbetën në makinë. I Akuzuari i tha B. T. se kishte dashur të zhvillojë një diskutim të shkurtë me Komandant B. O.. Posa shoferi u eci të kthehet në makinë dhe ishte gati të hyjë në ulësen e shoferit, i Akuzuari shkoi në drejtim të makinës nga ana e djathtë, hapi derën e parme të pasagjerit dhe pyeti B. O. “pse ke hequr fotografinë?”. Më vonë u sqarua se ishte fjala për fotografinë e A. J., e cila ishte hequr dikur më herët se incidenti nga zyra ku i Akuzuari ishte duke punuar në bazën e Forcave të Sigurisë së Kosovës në \_\_\_\_\_. Menjëherë posa e shtroi këtë pyetje, i Akuzuari, duke qëndruar jashtë makinës në një distancë shumë të shkurtër nga pala e dëmtuar, nxori revolen dhe filloi të qëllojë brenda makinës ë drejtim të këmbëve të palës së dëmtuar. Pas të shtënave i Akuzuari u largua nga vendi i kimit dhe eci në drejtim të fshatit \_\_\_\_\_. Për shkak të plagëve të pësuar, pala e dëmtuar është dashur t’i nënshtrohet disa operacioneve kirurgjike dhe, sot e kësaj dite, ende nuk e kë përfunduar trajtimin mjekësor, i cili do të zgjatë edhe disa trajtim dhe rehabilitim. Plagët e shkaktuara palës së dëmtuar ishin mjaft serioze të rezultojnë me dobësimin e përhershëm të gjymtyrëve duke zvogëluar kapacitetin e tij për punë.

Duke vepruar kështu, **Sh. K.** ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të **Lëndimit të Rëndë Trupor** në kundërshtim të Nenit 154, Paragrafit (1), Pikës 1), 2) dhe 4) të Kodit Penal të Kosovës.

Për më tepër, i **Akuzuari Sh. K.**

është

## FAJTOR

Sepse gjatë një periudhe të panjohur kohore gjer më \_\_\_\_\_, pa autorizim ishte në pronësi të revoles \_\_\_\_\_ të kalibrit \_\_\_\_\_ mm, të cilën ai e përdori në mënyrë të sipër përmendur.

Duke vepruar kështu, i Akuzuari **Sh. K.** ka kryer dhe është përgjegjës për vepër penale **Mbajtje në Pronësi, në Kontroll, në Posedim, në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve** nga Neni 328 paragraf 2 të KPK-së

**Prandaj, Sh. K.**

## DËNOHET

me

- Pesë (5) vjet burg për veprën penale të Lëndimit të Rëndë Trupor

- Tre (3) vjet burg për vepër penale Mbajtje në Pronësi, në Kontroll, në Posedim, në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve

Dënimi unik caktohet në shtatë (7) vjet burg sipas Nenit 71 Paragrafit (10 DHE Paragrafit (20 Pikës 2 të KPK-së.

Koha e kaluar në paraburgim nga \_\_\_\_\_ do të llogariten në përputhje me Nenin 73 Paragrafit (1) të KPK-së.

Revolja – \_\_\_\_\_ e kalibrit \_\_\_\_\_ mm, numri serik \_\_\_\_\_, me këtë konfiskohet në përputhje me Nenin 60 Paragrafin (1) dhe Nenin 328 Paragrafin (5) të KPK-së.

I akuzuari do të kompensojë shpenzimet e procedurës penale në përputhje me Nenin 102 Paragrafit (1) të KPPK-së me përjashtim të shpenzimeve të përkthimeve.

Dëmshpërblimi i Palës së Dëmtuar do t'i referohet procedurës civile në përputhje me Nenin 112 Paragrafit (2) të KPPK-së.

**Procesmbajtës**  
**Francesco de Sanctis**

**Gjyqtari Kryesues**  
**Klaus Jung**